

Morrat, informim për prindër

Nxënësit e shkollës sonë kanë morra në kokë. Për largimin e morrave është me rëndësi që në çdo shtëpi të gjithë fëmijëve të ju kontrollohet shumë me kujdes lëkura e kokës. Flokët dhe lëkura e kokës kontrollohen duke i ndarë flokët palë-palë dhe duke i kthyer flokët pak nga pak. Kështu kalohet dhe shiqohet tërë sipërfaqja e lëkurës së kokës. Përqëndroni vëmendjen posaqërisht në pjesët prapa veshëve dhe në pjesën e qafës.

Trajtimin për largimin e morrave të kokës mund të ia bëni fëmiut të juaj me shamponin NIX apo shamponin / tretjen PRIODERM. Shamponin mund ta bleni në barnatore dhe në pako janë udhëzimet e karta të përdorimit. Në të njejtën kohë lani çarçafët e fëmiut dhe të të gjithë anëtarëve tjerë të familjes në temperaturë 60 shkallë dhe dezinfikoni krahnat / brushat duke i zier apo duke i mbajtur 24 orë në ngrirës/friz ose dimrit jasht në acar. Veshjet/robat që lahen vështirë duhet të mbahen dy orë në sauna mbi 80 shkallë që të shkatrohen morrat dhe vezët e tyre. Poashtu është me rëndësi që të ia krehni flokët fëmiut të juaj për çdo ditë me krahën të shpeshë që gjindet në pakon e shamponit. Krehja largon mekanikisht larvat apo vezët e morrave. Larvat mund të largohen nga flokët edhe duke i kapur me gishta sepse krahni nuk është gjithmonë mjaft efikas.

Lëkura e kokës së fëmiut kontrollohet afërsisht një javë pas larjes. Kështu vërtetoheni se edhe larvat eventuale janë shkatruar. Trajtimi/kurimi për largimin e morrave sipas nevojës përsëritet për çdo javë me lloje tjera të shamponit. Larvat janë vezë të morrave si topëza të vogla të bardha afër lëkurës së kokës apo të ngjitura për fije floku.

Të gjallë morrat janë të madhësisë 0.5 - 3 mm, parazit të vegjël të zi apo me ngjyrë kafe të mbylltë, që lëvizin shpejtë nëpër lëkurën e kokës. Morrat kryesisht gjinden në pjesët pas veshëve dhe në qafë. Poashtu, në lëkurën e kokës mund të shifin pika të zeza të palëvizshme. Ato janë lëvore të morrave që largohen dhe humbin me krehjen e lëkurës së kokës.

Morrat ngjiten me kontakt. Andaj preferojmë që duart të lahen shpesh gjatë kësaj kohe. Poashtu, është mirë t'i përkujtoni fëmijët që të mos i ndrojnë kapelat apo robat tjera me shokë e shoqe dhe të përdorin vetëm krahnant dhe kaset e veta të flokëve. Kapelat dhe shallat duhet t'i mbajnë në dorzën e zhaketës së vete e jo në varse.

Lidhur me çështjen e morrave mund të kontaktoni sipas nevojës edhe me motrën medicinale.

Në qerdhe dhe në shkollë mund të shkojnë menjherë pas trajtimit të parë të fëmiut dhe të të gjithë anëtarëve të familjes që banojnë në të njejtën amvisni.

Morrat paraqiten vazhdimisht edhe në shtete të standardit të lartë jetsorë dhe nuk do të thot se është shenjë e higjienës së dobët. Kujdesi për shëndetin e qytetit Oulu

